

[Ligji no. 182, "Tarifa"](#)

[Ligji nr. 180, date 28.12.2013](#)

[Ligji nr. 183, date 28.12.2013](#)

Procedurat ligjore për miratimin e Marrëveshjeve Hidrokarbure dhe Licence Marrëveshjeve

Baza ligjore

Ligjit nr. Nr.7746, datë 28.7.1993 "Për hidrokarburet" i ndryshuar;

Rregullore "Për Procedurat e Miratimit të Marrëveshjeve Hidrokarbure dhe Licence Marrëveshjeve", miratuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;

Ligji nr. 10081 datë 23.02.2009 "Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë".

Marrëveshja hidrokarbure duhet të kalojë në këto hapa procedurale për t'u miratuar:

Subjektet e interesuara paraqesin pranë AKBN (në rastin e zonave që administrohen nga AKBN) ose Albpetrol-it (në rastin e zonave që administrohen nga Albpetroli) një aplikim për të hyrë në Marrëveshje Hidrokarbure;

AKBN ose Albpetrol, brënda 15 ditëve nga marrja e aplikimit, i paraqet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikes (METE) dokumentacionin e nevojshëm dhe kërkesën për miratimin e fillimit të negociimeve. METE jep aprovimin ose jo për fillimin e negociatave brenda 10 ditëve nga marrja e propozimit nga AKBN ose Albpetrol.

Në rast miratimi nga METE të kërkesës, përfaqësuesit e AKBN apo Albpetrol fillojnë negociimin me subjektin e interesuar për Termat dhe Kushtet Kryesore të Marrëveshjes Hidrokarbure. Pasi bien dakort, dokumenti nënshkruhet nga të dy palët dhe i përcillet Ministrisë për miratim brenda 10 ditëve nga data e nënshkrimit.

METE jep miratimin ose refuzimin e saj për Termat dhe Kushtet Kryesore të Marrëveshjes brenda 10 ditëve nga marrja e dokumentit të nënshkruar të Termave dhe kushteve kryesore të Marrëveshjes.

Në rastin e miratimit të Termave dhe Kushteve kryesore të Marrëveshjes Hidrokarbure, AKBN ose Albpetrol, fillojnë negociimet brenda 30 ditëve nga marrja e miratimit për Termat dhe Kushtet Kryesore të Marrëveshjes Hidrokarbure.

AKBN ose Albpetrol i përcjellë Ministrisë për miratim draftin përfundimtar të Marrëveshjes Hidrokarbure brenda 15 ditëve nga data e firmosjes së tij, në çdo faqe nga palët. Kur drafti çohet për oponentë, atëherë rinegociimi dhe rishikimi i draftit bëhen brenda 20 ditëve nga data e marrjes së oponentëve.

Drafti i nënshkruar nga palët, mund të dërgohet nga METE për oponentë si dhe për rishikim nga ana fiskale dhe ligjore, përkatësisht në Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Drejtësisë.

Rinegociimi dhe rishikimi i draftit në vijim të oponentëve dhe opinionëve që mund të kenë nga ana fiskale dhe ligjore ministritë përkatëse kryhet brenda 20 ditëve nga marrja e oponentëve dhe opinionëve, dhe pasi është rënë dakord për rinegociimin dhe rishikimin dërgohet në METE brenda 10 ditëve.

METE nënshkruan Marrëveshjen Hidrokarbure brenda 10 ditëve nga marrja e marrëveshjes së rinegociuar, në rastin e zonave të administruara nga AKBN, dhe me pas e dërgon për miratim përfundimtar në Këshillin e Ministrave

METE jep miratimin për nënshkrimin e Marrëveshjes Hidrokarbure brenda 10 ditëve nga marrja e marrëveshjes së rinegociuar, në rastin e zonave të administruara nga Albpetrol, dhe me pas e dërgon për miratim përfundimtar në Këshillin e Ministrave.

Liçensë Marrëveshja duhet të kalojë në hapat e mëposhtme për t'u miratuar

Albpetrol paraqet, brenda 10 ditëve nga miratimi nga METE i të Termave dhe Kushteve Kryesore të Marrëveshjes Hidrokarbure, pranë AKBN kërkesën për t'u pajisur me Liçencë Marrëveshje;

AKBN përgatit brenda 30 ditëve dhe i dërgon Albpetrol-it draftin e Liçencë Marrëveshjes i cili diskutohet mes Albpetrol-it dhe AKBN për një periudhë kohore 50 ditësh.

Drafti përfundimtar, i nënshkruar në çdo faqe, paraqitet brenda 10 ditëve në METE për miratim dhe nënshkrim.

METE brenda 10 ditëve nënshkruan apo kërkon bërjen e ndryshimeve. Në rast të ndryshimeve, këto duhet të kryhen brenda 30 ditëve dhe drafti i rishikuar i Liçencë Marrëveshjes riparaqitet për nënshkrim.

Liçencë Marrëveshja nënshkruhet nga Ministri dhe Albpetrol brenda 10 ditësh nga data e

miratimit të Marrëveshjes Hidrokarbure nga Ministri.